

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEGA NË SHTËRPCË**, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Musa Konxheli, me asistentin Muedin Rexhepi, në lëndën penale kundër A.S. nga fshati... komuna Shtërpçë, i akuzuar me aktakuzën e Ptokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.754-2/16 të dt.07.09.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur rreth kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.22.09.2017 solli

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.754-2/16 e dt.07.09.2017 dhe kjo gjykatë jep:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

I akuzuari **A.S.** nga fshati... Komuna Shtërpçë, i lindur më data e lindjes... , në të njëjtin vend, nga i ati H..., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal ..... mbrohet në liri,

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse me dt.14.05.2016.rreth orës 07:15, në rrugën e fshati Brod, Komuna Shtërpçës,duke lëvizur në drejtim të rrugës kryesore Ferizaj – Shtërpçë,duke drejtuar automjetin e markës ..... me terga te regjistrimit ..... duke vepruar në kundështrim me depozitat e nenit 55/1 të LSKRR-së,nga pakujdesia,duke mos e mbjatur distancën e nevojshme të sigurisë me automjetin para tij gjatë lëvizjes me pjesën e përprame e godet në pjesën e pasme automjetin e markës ..... ,me targë të regjistrimit ..... të cilin e drejtonte, D.S. e pastaj ky automjet e godet nga forca e inercionit autobusin e markës ..... me targë ..... të cilin e drejtonte R.S. me të cilin rast pos dëmeve materiale

lëndime të lehta trupore pësojnë pasagjeret R.K., J.S., V.H. , dhe D.S. lëndime këto të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të datës 15.08.2017.

**Me çka ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPR-së**

- Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 495 të KPPRK-së i shqipton

### **DËNIM ME GJOBË**

Të akuzuarit **A.S.** i shqiptoi dënimin në shumë prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet t'a paguan në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Gjykata të dëmtuarint R.K., J.S., V.H., dhe D.S. me vendbanim në fshatin.... Komuna e Shtërpcës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale të paguan shumën prej 90.88 € dhe paushallit gjyqësor të paguan shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.754-2/16 të dt.07.09.2017 e ka akuzuar A.S. nga fshati... komuna e Shtërpcës se e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par.1.2 dhe 3 të KPPK-së.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës, gjegjësisht konstatimin dhe mendimin nga ekspertit mjeko-ligjor të dt.15.08.2017. lidhur me llojin dhe natyrën e

lëndimeve për të dëmtuarit R.K., J.S., V.H., dhe D.S. konstatimi dhe mendimi i ekspertit të Komunikacionit e dt.24.07.2017, skica dhe fotografitë e aksidentit-vendit të ngjares, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse sepse vërtetojnë që i akuzauri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.1 lidhur me par.3 të KPRK-së të dëmtuarit R.K. ,J.S., V.H., dhe D.S. me vendbanim në fshatin ..... komuna Shtërpcës, për realizim e kërkes pasurore –juridike jane udhëzuar në kontest civil.

Konform nenit 450 par.2.6 të KPRK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguan shumën prej 90.88 Euro dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEGA NË SHTËRPCË**

**P.nr.204/2017 i dt.22.09.2017.**

**Gjyqtari**

Musa Konxheli

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së të njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotëfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.